



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA- REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivery	21. 12 2021	viti god year	
Organ /Njesia Organ./Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSSHCK	6252/2021		113



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVILA TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A. Nr.966/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Rushit Kajtazi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.966/2021 të datës 25.11.2021 të parashtruar nga ankuesja me adresë banim: Rr."Zenel Salihu" Nr. 22, Prishtinë, kundër organit të punësimit Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 21.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.Nr.966/2021 e datës 25.11.2021, e parashtruar nga ankuesja
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër protokolli 2021/BNJ/332 i datës 23.11.2021, i Udhëheqëses së Njesisë së Burimeve Njerëzore të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës.

Arsyetim

Ankuesja e punësuar në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës, me datë 25.11.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, kundër Vendimit me numër protokolli 2021/BNJ/332 të datës 23.11.2021 të Udhëheqëses së Njesisë së Burimeve Njerëzore të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, më datë 30.11.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit të Agjencia Kosovare e Privatizimit.

Ndërsa, Këshilli më datë 03.12.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë, se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas konstatimit së ankesa është e pranueshme sipas nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, për vendosje meritore, ka administruar këto prova: Ankesën A. Nr. 966/2021, e datës 25.11.2021, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër protokollit 2021/BNJ/332 të datës 23.11.2021, të Udhëheqëses së Njesisë së Burimeve Njerëzore të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës; e-mailin e datës 22.11.2021 nga e-mailin e datës 23.11.2021 nga e-mailin e datës 01.11.2021, Vërejtjen e datës 28.10.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit të Civil të Kosovës, e-mailin e datës 18.11.2021 nga S.S për B.E, e-mailin e datës 15.11.2021 nga f 1/2, ftesën dhe agjendën për pjesëmarrje në trajnim nga IKAP për data 15-16 nëntor 2021; kërkesën për pushim të datës 18.11.2021 të e-mailin e datës 22.11.2021 të s.S për B.E nga f1/3, e-mailin e datës 12.11.2021 të S.S për Xh.B, Përgjigjen në ankesë të datës 03.12.2021, me numër protokollit 5799/2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, konstatoi se ankesa e ankueses është e pabazuar sepse:

Nga vlerësimi i shkresave të lëndës është konstatuar se ankuesja është e punësuar në pozitën e punës Drejtoreshë në Departamentin për Administratë dhe Burime Njerëzore, pranë Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës(me tej AACK).

Me datë 28.10.2019, Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit të Civil të Kosovës ka shqiptuar ndaj ankueses masën disiplinore "Vërejtje", me arsyetimin se e njëjta nuk ka respektuar urdhrat e Drejtorit të Përgjithshëm të AACK-së.

Më kërkesë të ankueses, Udhëheqësja e Njesisë së Burimeve Njerëzore të AACK-së ka nxjerrë Vendimin me numër protokollit 2021/BNJ/332 të datës 23.11.2021, me të cilin ka fshirë nga dosja e personelit dhe regjistri përkatës masën disiplinore "Vërejtje" e shqiptuar nga Drejtori i Përgjithshëm i AACK-së ndaj ankueses me datë 28.10.2019. Kundër këtij vendimi, ankuesja parashtron ankesë në KPMSHCK me pretendimet se vendimi i atakuar nuk ka për synim fshirjen e masës disiplinore "Vërejtje", por ka për qëllim të krijoj një masë me pasoja të pashlyeshme asnjëherë.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankueses Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkatësisht nenin 51 paragrafi 1, nen paragrafi 1.1 më të cilin është përcaktuar se: "Masat disiplinore të shënuara në dosjen e personelit shuhen, pas kalimit të këtyre afateve: 1.1. dy (2) vjet nga njoftimi i masës së parashikuar në paragrafët 1.1 dhe 1.2 të nenit 47 të këtij ligji" si dhe nenin 14 të Rregullores(QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë ku parashihet se: "Masat disiplinore të shënuara në dosjen e personelit shuhen sipas afateve të parapara në nenin 51 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 deri 1.3 të Ligjit.2.Shuarja e masës disiplinore bëhet sipas detyrës zyrtare, apo me kërkesë të nëpunësit që i është shqiptuar masa disiplinore me vendim të njësisë së burimeve njerëzore të institucionit. 3. Masa disiplinore duhet të fshihet edhe nga dosja e personale dhe nga regjistri përkatës i SIMBNJ-së dhe si rrjedhojë ka konstatuar se masa disiplinore



“vërejtje” shuhet dy (2) vite nga data e njoftimit të nëpunësit civil më masën në fjalë, shuarja bëhet ex officio ose me vendim të Njesisë së Burimeve Njerëzore të institucionit sipas kërkesës së nëpunësit civil, dhe si e tillë duhet të largohet nga dosja personale e nëpunësit civil dhe regjistri përkatës i SIMBNJ-së. Në kuptim të këtyre dispozitave ligjore dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka gjetur se ankuesja përmes emailit zyrtar me datë 15, 17 dhe 22 nëntor 2021, ka parashtruar kërkesë të Udhëheqësja e Burimeve Njerëzore për fshirjen e masës disiplinore “Vërejtje” të datës 28.10.2019 nga dosja e saj personale, ndërsa Udhëheqësja e Njesisë së Burimeve Njerëzore të AACK-së, me Vendim me numër protokolli 2021/BNJ/332 të datës 23.11.2021, ka fshirë nga dosja personale dhe regjistri përkatës masën disiplinore “vërejtje” të shqiptuar ndaj ankueses nga Drejtori i Përgjithshëm me datë 28.10.2019.

Andaj, bazuar në konstatimin si me lartë, Kolegji vlerëson së Udhëheqësja e Burimeve Njerëzore të AACK-së ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, e mbi këtë bazë Kolegji konstaton se janë të pabazuara pretendimet ankimore të ankueses, sepse masa disiplinore “vërejtje” e datës 28.10.2019, edhe përkundër vendimit të kontestuar për fshirjen e saj, e njëjta ex officio konsiderohet e shlyer nga data 28.10.2021, përkatësisht nga kjo datë masa disiplinore në fjalë nuk prodhon ndonjë pasojë juridike në raport me të drejtat dhe detyrimet e ankueses.

Bazuar në rrethanat si me lartë, si dhe duke mbështetur në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A. Nr. 966/2021

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Ardita HAXHNIKAJ DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Autoritetin e Aviacionit ACivil të Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK-së.